



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 2024/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Telekom i Kosovës sh.a – me seli në Prishtinë, ndaj debitorit N.P.T “B...”, me pronar A.S, me NRB ....., në Ferizaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.225/2022 të datës 25.03.2022 të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 27.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit N.P.T “B...”, me pronar A.S, i paraqitur kundër urdhrit përmbartimor P.nr.225/22 të dt. 25.03.2022, të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferi.
- II. MBETET në fuqi Urdhri P.nr.225/22 të dt. 25.03.2022, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Isa Gacaferi – Vais Law, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Telekom i Kosovës sh.a me seli në Prishtinë, në bazë të titullit ekzekutiv – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III. C.nr.213/14 i datës 06.05.2015, ka nxjerrë urdhrin P.nr.225/2022 të datës 25.03.2022, me të cilin ka caktuar zbatimin e përmbartimit ndaj debitorit N.P.T “B...”, me pronar A.S, me NRB ....., Ferizaj dhe ka detyruar debitorin që në emër të përmbushjes së obligimit të pa paguar brenda 7 ditësh, nga dita e dorëzimit të urdhrit, ti paguaj kreditorit shumën prej 627.60 € si dhe shpenzimet e procedurës së përmbartimit.

Debitori, në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ndër të tjera ka deklaruar se shuma që kërkohet nga kreditori nuk përkon me gjendjen faktike, duke shtuar se kontratën me kreditorin e ka lidhur vëllai i tij, i cili ka qenë në cilësinë e punëtorit dhe se i njëjti nuk është shpenzues i këtyre impulseve telefonike. Më tutje ka shtuar se ka kaluar afati i parashkrimit sipas nenit 360 par 1.3 dhe 352 të LMD –së, pasi që nga momenti i lidhjes së kontratës deri në ditën e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë dhe dita e paraqitjes së propozimit për përmbarim kanë kaluar mbi dhjetë vite dhe i ka propozuar gjykatës që propozimi i kreditorit të refuzohet si i pa bazuar dhe të pezullohen të gjitha veprimet e deritanishme të ndërmarra në këtë çështje.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, duke theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se kërkesa është e parashkruar, për faktin se kërkesat e vërtetuara nga gjykata ose organet tjera kompetente parashkruhen për dhjetë viteve, sipas dispozitave të nenit 361 të LMD-së. Më tutje ka theksuar se prapësimi nuk i plotëson kushtet nga neni 69 pika 4 të LPP –së, sepse baza për prapësim duhet të mbështetet në prova të duhura dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimin ta hedh poshtë si të pa kompletuar, të pa lejuar dhe të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Gjykata erdhi në përfundim se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, për faktin se në prapësimin e debitorit nuk janë dhënë arsye që prapësimi të pranohet si i bazuar dhe të anulohet urdhri përmbarimor, ndërsa e ka lënë në fuqi Urdhrin e Përmbaruesit Privat P.nr.225/22 të datës 25.03.2022, pasi që i njëjti është lejuar në bazë të dokumentit përmbarues (titullit ekzekutiv) – Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III. C.nr.213/14 i datës 06.05.2015, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 02.03.2017 dhe i ekzekutueshëm nga data 17.03.2017.

Sipas dokumentit përmbarues (titullit ekzekutiv) - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III. C.nr.213/14 i datës 06.05.2015, debitori është detyruar që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumë prej 627.60 €, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarimit me dhunë.

Gjykata gjeti se dokumenti përmbarimor – Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Ekonomik III. C.nr.213/14 i dt. 06.05.2015, i formës së prerë prej datës 02.03.2017 dhe i ekzekutueshëm prej datës 17.03.2017 është dorëzuar në origjinal dhe si i tillë i plotëson kushtet ligjore sipas nenit 38 par 1. të LPP-së, i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit– vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit”*.

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 22 par. 1, pika 1.1, përcaktohen dokumentet përmbaruese siç janë: *“vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;”*, ndërsa me nenin 23. par.1 përcaktohet se *“ vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit.”*, dhe nenin 24 par. 1 përcaktohet të LPP-së përcaktohet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilin është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje, është i përmbarueshem po që se ka marrë formë të prerë, si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare.”*, ndërsa me nenin 27 par.1 të LPP-së përcaktohet se *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se urdhri për përmbarrim i caktuar mbi bazën e titullit ekzekutiv i plotëson kushtet për tu paraqitur si dokument përmbarrues dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbarrimit, ngase janë plotësuar kushtet ligjore sipas nenit 21, nenit 22 par.1 pika 1.1, nenit 23 par.1, nenit 24 par. 1 dhe nenit 27 të LPP-së, pasi që aktgjykimi i lartcekur, është i përmbarrueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbarrim, pasi që në të janë treguar palët përkatësisht kreditori dhe debitori, është përcaktuar shuma e cila përbën detyrim për përmbarrje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbarrjes së këtij detyrimi.

Gjykata vlerësoj pretendimet e debitorit në prapësim se nga momenti i lidhjes së kontratës deri në ditën e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë dhe deri tek dita e paraqitjes së propozimit për përmbarrim kanë kaluar mbi dhjetë vite dhe se kërkesa është parashkruar dhe erdhi në përfundim se një pretendim i tillë i debitorit është pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit dhe përmbarrjes së dokumentit përmbarrimor –Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III.C.nr.213/14 i datës 06.05.2015, meqenëse procedura përmbarrimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi.

Gjykata po ashtu gjen se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë as me parashkrim të kërkesave të vërtetuara nga gjykata me vendim të formës së prerë, pasi që bazuar në dispozitën e nenit 361 par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me të cilën përcaktohet se “ *Të gjitha kërkesat që janë vërtetuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent, ose me ujdinë e palëve para gjykatës apo organit tjetër kompetent, parashkruhen për dhjetë (10) vjet, madje edhe ato për të cilat ligji edhe ashtu parashikon afat më të shkurtër për parashkrim.*”, rezulton se propozimi për përmbarrim është paraqitur brenda afatit dhjetë (10) vjeçar të përcaktuar si më lartë, pasi që Urdhri Përmbarrimor P.nr.225/2022 është lëshuar me datën 25.03.2022 ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike III. C.nr.213/14 i datës 06.05.2015, ka marrë formën e prerë me datën 02.03.2017 dhe është bërë i ekzekutueshëm prej datës 17.03.2017.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata lidhur me këtë çështje përmbare, vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbaremit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 par.1 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2024/22, datë 27.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.